



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V
Sesioni pranveror

Kryesia e Kuvendit

P-056

Prishtinë, më 4 mars 2016, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala C -301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 4 MARS 2016

Në mbledhje morën pjesë: Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit, Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Aida Dërguti dhe Fikrim Damka, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Adem Grabovci, Ismet Beqiri, Slavko Simiq dhe Myfera Shinik.

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Blerim Latifi dhe Avni Bytyçi.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Xheladin Hoxha, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Musli Krasniqi.

Nga Zyra e BE-së: Blerta Bejtullahu,

Nga OSBE-ja: Sanije Berisha,

Nga NDI-ja: Shefki Kastrati dhe

Nga KDI-ja: Albert Krasniqi.

Mbledhjen e drejtoi **Kadri VESELI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Kryesia, me propozimin e kryetarit, i zhvilloi punimet me këtë:

Rend dite

- 1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjeve të Kryesisë, të mbajtura më 16 dhe 24 shkurt 2016.*
- 2. Përgatitjet për seancën plenare të radhës,*
- 3. Shqyrtimi i propozimeve dhe kërkesave dhe*
- 4. Të ndryshme.*

1. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të Kryesisë, të mbajtura më 16 dhe 24 shkurt 2016

Kryesia i miratoi pa vërejtje procesverbalet e mbledhjeve të Kryesisë, të mbajtura më 16 dhe 24 shkurt 2016.

* * *

Më pas, kryetari i njoftoi anëtarët e Kryesisë së Kuvendit rreth përgatitjeve për shënimin e Epopesë së 5, 6 dhe 7 Marsit, përkatësisht rënies së Komandantit Legjendar Adem Jashari, si dhe rreth bisedave që janë duke u zhvilluar me Kuvendin Komunal të Prishtinës për ngritjen e shtatores së Komandantit Legjendar në sheshin “Adem Jashari”.

2. Përgatitjet për seancën plenare të radhës

Kryesia, pasi i shqyrtoi përgatitjet për seancë plenare, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare të pranishme në mbledhje, me shumicë votash (4 “për” dhe 1 “kundër” - Aida Dërguti), vendosi që seanca plenare e Kuvendit të mbahet të enjten, më 10 mars 2016, në orën 10:00, me këtë:

Rend dite

- 1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,*
- 2. Koha për pyetje parlamentare,*
- 3. Miratimi i procesverbalit nga seanca e mëparshme,*
- 4. Formimi i Organit Përzgjedhës të Pavarur për përzgjedhjen e anëtarëve në Organin Shqyrtues të Prokurimit,*
- 5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për gazin natyror,*
- 6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Rregullatorin e Energjisë,*
- 7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për energjinë elektrike,*
- 8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për energjinë,*
- 9. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për tregtinë me produkte të naftës dhe karburante të ripërtërishme në Kosovë,*
- 10. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për falimentimin,*
- 11. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për rregullat e komunikacionit rrugor,*
- 12. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për siguri në punë në veprimtarinë minerare,*
- 13. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për mjekësinë ligjore,*

14. *Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Integritet Evropian lidhur me Programin Kombëtar për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit,*
15. *Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit për standardizimin,*
16. *Propozimi për formimin e Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës,*
17. *Propozimi për formimin e Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Komisionit të Pavarur për Medie,*
18. *Propozimi i Grupit Parlamentar të PDK-së për emërimin e anëtarëve në komisionet parlamentare.*

* * *

Kryesia e Kuvendit gjithashtu lidhur me pikat 16 dhe 17 të lartshënuara të rendit të ditës, nxori edhe këto përfundime:

I. Përfundim

1. Kërkohej nga grupet parlamentare të Kuvendit që deri në seancën e radhës, më 10 mars 2016, t'i propozojnë deputetët për kryetar, zëvendëskryetar dhe anëtarë të Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Bordit të Radiotelevizionit të Kosovës.
2. Përbërja e Komisionit ad hoc duhet të jetë, si në vijim: GP i PDK-së 2 anëtarë, GP i LDK-së 2 anëtarë, GP VV 1 anëtar, GP i AAK-së 1 anëtar, GP Lista serbe 1 anëtar, GP "Nisma" 1 anëtar dhe GP "6+" 1 anëtar.

II. Përfundim

1. Kërkohej nga grupet parlamentare të Kuvendit që deri në seancën e radhës, më 10 mars 2016, t'i propozojnë deputetët për anëtarë të Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Komisionit të Pavarur të Medieve.
2. Përbërja e Komisionit ad hoc duhet si në vijim: GP i PDK-së 2 anëtarë, GP i LDK-së 2 anëtarë, GP VV 1 anëtar, GP i AAK-së 1 anëtar, GP Lista serbe 1 anëtar, GP "Nisma" 1 anëtar dhe GP "6+" 1 anëtar.

3. Shqyrtimi i propozimeve dhe kërkesave:

1. Formimi i Komisionit Parlamentar për MSA (13 anëtarë)

Kryetari i njoftoi anëtarët e Kryesisë së Kuvendit se Parlamenti Evropian, respektivisht udhëheqësi i delegacionit nga Parlamenti Evropian për Marrëdhënie me Bosnjë-Hercegovinën, Kosovë, Malin e Zi dhe Serbinë, z. Tonino Picula, në bazë të artikullit 15 dhe 132 të Marrëveshjes për Stabilizim-Asociim, ka kërkuar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës që t'i nominojë trembëdhjetë (13) deputetë të Kuvendit të Kosovës që do të jenë pjesë e Komisionit Parlamentar për Stabilizim-Asociim, i cili do të përbëhet nga trembëdhjetë (13) deputetë të Kuvendit të Kosovës dhe trembëdhjetë (13) anëtarë nga Parlamenti Evropian.

Kryesia, pasi diskutoi lidhur me formimin e Komisionit parlamentar për MSA, mori këtë:

Vendim

1. Formohet Komisioni Parlamentar për Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit ndërmjet Kosovës, në njërën anë, dhe Bashkimit Evropian dhe Komuniteti Evropian të Energjisë Atomike, në anën tjetër.
2. Komisioni përbëhet prej 13 anëtarëve, si në vijim: GP i PDK-së 4 anëtarë, GP i LDK-së 4 anëtarë, GP VV 1 anëtar, GP i AAK-së 1 anëtar, GP Lista serbe 1 anëtar, GP “Nisma 1 anëtar dhe GP “6+” 1 anëtar.
3. Kërkohet nga grupet parlamentare të Kuvendit që në afatin sa më të shpejtë t’i propozojnë deputetët për anëtarë dhe zëvendësanëtarë të Komisionit Parlamentar për Stabilizim-Asociim ndërmjet Kosovës, në njërën anë, dhe Bashkimit Evropian dhe Komunitetit Evropian të Energjisë Atomike, në anën tjetër.

Vendimi për formimin e Komisionit Parlamentar për Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit do të hyjë në fuqi pasi që kryetarët e grupeve parlamentare t’i propozojnë anëtarët dhe zëvendësanëtarët e komisionit, bazuar në pikën 2 dhe 3 të vendimit të lartshënuar.

2. Kërkesa për lejimin e udhëtimit zyrtar në Turqi, prej 19-23 prill 2016

Kryesia, pasi e shqyrtoi kërkesën e lartshënuar, mori këtë:

Vendim

1. Lejohet udhëtimi zyrtar i deputetëve të Kuvendit, z. Agim Çeku dhe z. Besim Beqaj, për të marrë pjesë në Forumin e Tetë Ndërkombëtar Ballkanik, me temë: “Tregtia, Investimet, Financa dhe Konkurrenca”, i cili do të mbahet në Turqi, prej 19-23 prill 2016,
2. Të gjitha shpenzimet për realizimin e këtij udhëtimit për të lartshënuarit në pikën 1 (një) të këtij vendimi mbulohen nga buxheti i Kuvendit të Republikës së Kosovës.
3. ***Njoftimi i dy (2) nënkryetarëve të Kuvendit lidhur me pjesëmarrjen në punimet e Sesionit të Parë të Rregullt të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës, prej 25-29 janar 2016***

Kryesia u njoftua me raportin e nënkryetarëve të Kuvendit, z. Xhavit Haliti dhe znj. Aida Dërguti, lidhur me pjesëmarrjen në punimet e Sesionit të Parë të Rregullt të Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Evropës, prej 25-29 janar 2016.

4. Njoftimi i Komisionit për Integrime Evropiane lidhur me vizitën zyrtare të realizuar në Bruksel, prej 26-29 janar 2016

Kryesia u njoftua me raportin e Komisionit për Integrime Evropiane lidhur me vizitën zyrtare të realizuar në Bruksel, prej 26-29 janar 2016.

5. Të ndryshme:

Nënkryetari i Kuvendit, Fikrim Damka, propozoi që për nder të 8 Marsit - Ditës Ndërkombëtare të Gruas, Kuvendi i Kosovës t’u dhurojë nga një lule grave deputete.

Kryetari e mbështeti propozimin e nënkryetarit Fikrim Damka.

Ai i njoftoi të pranishmit se me rastin e 8 Marsit - Ditës Ndërkombëtare të Gruas, për të gratë deputete dhe atyre të Administratës së Kuvendit do të organizohet një mbrëmje në hotelin “Emerald” në Prishtinë.

Kryesia pasi diskutoi lidhur me shënimin e 8 Marsit - Ditës Ndërkombëtare të Gruas, mori këtë:

Vendim

1. Lejohet mbulimi i shpenzimeve me rastin e shënimit të 8 Marsit - Ditës Ndërkombëtare të Gruas.
2. Mjetet e parapara në pikën 1 (një) të këtij vendimi ndahen nga kategoria ekonomike “mallra dhe shërbime.

Kryetari e përfundoi mbledhjen e Kryesisë së Kuvendit në orën 12:10 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Kadri VESELI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtoria për Çështje Plenare dhe Procedurale